



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 458 Prot.

Tiranë, më datë 17.05.2022

VENDIM
Nr. 174, datë 17.05.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 17.05.2022:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për Raportin e vëzhgimit arkeologjik nga individ i licencuar Skënder Muçaj, Suela Xhyheri dhe Klodian Velo, për projektin “Pikëvrojtime përgjatë itinerarit turistik në Shqipërinë e Jugut-Qeparo” Bashkia Himarë me aplikues MAU dhe zhvillues FSHZH:
 - Projekti të jetë në përputhje me VKM Nr. 636, datë 7.9.2016 “Për Shpalljen e Qendrës Historike të Fshatit Qeparo dhe miratimin e Rregullores për Administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”;
 - Të rishikohet i gjithë dokumentacioni teknik në lidhje me projektin.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

